



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranimi - Prillogje Nr. 02-02-2026			
Nr. i dokumentit	Nr. i vendimit	Nr. i vendimit	Vlera
07-110/05-758			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, bazë të nenit 12, shkronja d, neni 51, paragrafi 1, neni 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 3, neni 8 i Udhëzimit Administrativ MAPL-05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, nenit 36, shkronja d, neni 40, 41, shkronja b, neni 44, të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2026 miraton këtë:

V E N D I M

për themelimin e Komitetit për Komunitete

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin që ta themelon Komitetin për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Komiteti për Komunitete ka 7 anëtare dhe atë:

1. Djellza Fejzullahu Anëtar e kuvendit, (nga LDK-ja), anëtar i Komitetit për Komunitete;
2. Visar Demiri Anëtar i kuvendit, (nga PDK-ja), anëtar i Komitetit për Komunitete;
3. Elham Emërllahu Anëtar i kuvendit, (nga Nisma), anëtar i Komitetit për Komunitete;
4. Sanja Dajić-Vasić i komunitetit serb, anëtar i Komitetit për Komunitete;
5. Nenad Ilić, serb, i komunitetit serb anëtar i Komitetit për Komunitete;
6. Kata Pala i komunitetit kroat, anëtar i Komitetit për Komunitete;
7. Rifat Aniqi i komunitetit ashkali, anëtar i Komitetit për Komunitete.

Neni 3

Detyrat e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara në neni 53, paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, dhe të nenit 7 të Udhëzimit administrativ Nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera.

Neni 4

Anëtarët e Komitetit për Komunitete, të emëruar në nenin 2 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të Kuvendit të Komunës. Në Kuvendin Komunal të Vitisë nuk kemi anëtar të kuvendit nga komunitetit joshumicë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të KK-së;
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

K R Y E S U E S I

Bekim Azizi